Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 107 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me nenin 17 pika 13 të Rregullores së Punës, Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datën: 10.08.2022, shpallë këtë:

K O N K U R S
PËR EKSPERTË TË JASHTËM PROFESIONAL TË PROKURIMIT DHE EKSPERTË TEKNIK

Përmes së cilit i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 25 pika 3 të Rregullores Nr.01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Autoriteteve Kontraktuese dhe operatorëve ekonomik do të përpilojë dhe mbajë regjistrin e **Ekspertëve Profesional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, të kualifikuar për shqyrtimin e ankesave të Operatorëve Ekonomik, të cilët do të angazhohen (ad hoc) sipas rasteve për shqyrtimin e ankesave dhe zbatimit të aktiviteteve të Prokurimit, konform kushteve të përcaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që brenda afatit të caktuar në shpallje të paraqiten me dokumentacionin përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

<u>Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspertë Profesional të Prokurimit janë:</u>

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
2. Të ketë zotësi të plot të veprimit
3. Diplomë universitare te Fakultetit Juridik dhe Ekonomik
4. Të ketë së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit;
5. Të jenë të paanshëm në vendosje, me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit;
6. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkëngjisin aplikacionit këto dokumente :

- Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
-Vërtetimin mbi përvojën e punës pas diplomimit;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
-Çertifikatën nga evidence penale, e lëshuar nga gjykata; dhe
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspert të Jashtëm Teknik janë:

1. Të kenë të kryer Fakultetin e lëmive si në vijim:

- **Inxhinier të Ndërtimtarisë, Hidro, Konstruksion;**
- **Inxhinier të Arkitekturës;**
- **Inxhinier të Makinerisë;**
- **Inxhinier të Bujqësisë, Veterinarisë, Agrobiznes;**
- **Inxhinier të Gjeodezisë;**
- **Inxhinier të Xehetarisë;**
- **Inxhinier të Elektroteknikes;**
- **Inxhinier të Komunikacionit;**
- **Inxhinier të Teknologjisë Informative;**
- **Kimist/e;**
- **Farmacist/e;**
- **Biolog/e.**

2. E preferueshme është qe kandidatët të kenë pesë (5) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit;
3. Të jenë të paanshëm në vendosje, me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit;
4. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkëngjisin aplikacionit këto dokumente :

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
-Vërtetimin mbi përvojën e punës pas diplomimit;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
-Çertifikatën nga evidence penale, e lëshuar nga gjykata; dhe
- Kopjen e letërnjoftimit;

Dokumentet dorëzohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit / Zyra e Personelit (Adresa : Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës se Lublanës, Kati i V-të, Prishtinë) ose përmes e-mailit : **arta.S.berisha@rks-gov.net.**

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bëre ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrin brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata shtesë mund të kontaktoni me **Zyrën e Personelit** në numrin e telefonit: **038/212-360 prej orës 08:00 – 16:00.**

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në faqen e OSHP-së, prej datës: 10.08.2022 deri më datën: 24.08.2022 në ora 16:00.

Pas përfundimit të përpilimit të listës së **Ekspertëve Profesional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, Organi Shqyrtues i Prokurimit, do të informojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për **"Ekspert Profesional të Prokurimit në OSHP dhe për Ekspert të Jashtëm Teknik ".**

Prishtinë,

10.08.2022